

PROGRAMI I ALEANCËS KOSOVA E RE (AKR) 2019

Është e qartë që çdo Qeveri në ardhje do të trashëgojë një agjendë të ngjeshur dhe shumë sfiduese, pothuajse në të gjitha fushat e qeverisjes. Lista e çështjeve që kërkojnë zgjidhje dhe adresim të menjëhershëm është e madhe; ajo ngërthen detyra dhe obligime në të paktën tre drejtime dhe atë: Çështje të brendshme, avancimi i politikës së jashtme dhe proceseve integruese si dhe dialogun me Serbinë, taksa dhe marrëdhëniet fqinjësore.

1. ÇËSHTJET E BRENDSHME:

1.1. Sundimi i Ligjit:

77,5 % e kosovarëve i perceptojnë gjyqësorin, prokurorinë dhe institucionet e tjera të drejtësië, si të ndikuara nga politika dhe të korruptuara. Ne do të ndryshojmë këtë perceptcion. Është e qartë që sundimi i ligjit mbetet i dobët dhe joefikas. Korrupsioni është endemik në të gjitha nivelet institucionale dhe shoqërore. Kjo duhet të ndryshoj në mënyrë urgjente.

Korrupsioni, ndikimi në punësim, mungesa e efikasitetit, numri i ulët i gjyqtarëve dhe prokurorëve, administrata jo funksionale, kapacitetet e limituara, organet udhëheqëse jo-funksionale mbeten problemet kryesore në sistemin e drejtësisë si dhe ndryshimi i infrastrukturës ligjore.

Ne mbesim të përkushtuar për të përmisuar performancën dhe perceptimin e publikut për gjyqësorin. Qeveria e udhëhequr nga ne, përveç se do të shtoj buxhetin, gjithashtu do të bëjë disa hapa, mbi të gjitha, duke siguruar mos-ndërhyrjet politike..

Në këtë drejtim, ne do të bëjmë:

- a. Rishikimi funksional të institucioneve të sundimit të ligjit me qëllim që të sigurohet me shumë llogaridhënie, transparencë, qasje në drejtësi, rrjedhimisht funksionimin e gjyqësorit.
- b. Rritja e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve edhe pse është thelbësor nuk mund të prodhojë efekte pa ndryshim rrënjësor në administratën e gjyqësorit. Në këtë drejtim, ne do të prezantojmë pakon e pensionimit vullnetar të parakohshëm për gjyqtarët, prokurorët dhe stafin administrativ i cili do t'i hapte rrugë profesionistëve të rinjë
- c. Rritjen e buxhetit për Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial;
- d. Trajnimin e vazhdueshëm për stafin administrativ;
- e. Ndryshimin e infrastrukturës ligjore, me qëllim të luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar;
- f. Ndryshimin e infrastrukturës ligjore, me qëllim që proceset gjyqësore të përfundojnë në kohë sa më të shpejtë;
- g. Fillimin e procesit të vetingut;
- h. Themelimi i gjykatës ekonomike me procedura të shpejta (fast track); dhe
- i. Prezantimin e organeve të reja mbikëqyrëse në nivele të larta të inspektimit.

Aleanca Kosova e Re po ashtu, do të zhvilloj programin e gjyqtarëve të rinj, program që ka për qëllim inkuadrimin e të gjithë juristëve të diplomuar dhe sapo diplomuar në sistemin e drejtësisë. Të gjithë juristët, do të shërbejnë si krah i shtuar i gjyqtarëve aktual, për të përshpejtuar kontrollimin e të gjitha lëndëve në proces. Sot, kemi me mijëra lëndë të cilat nuk trajtohen për shkak të numrit të vegjël të gjyqtarëve. Programi i juristëve të rinj do të ndihmonte në zgjidhjen e këtij problemi.

1.2. Reformimi i Administratës Publike:

Që nga shpallja e Pavarësisë është evidentë që janë krijuar shumë institucione të cilat aktualisht janë të nevojshme por që funksionimi i tyre mbetet i dobët. Sot kemi një administratë të fragmentuar dhe të ndikuar thellësisht nga politika e cila në përgjithësi dështon të performoj. Veçanërisht nivelet e larta menaxheriale janë të lidhura ngusht me politiken dhe tejet të dobëta.

Reformimi i Administratës Publike është i lidhur ngusht me agjendën evropiane dhe synimet e Republikës së Kosovës për integrim në Bashkimin Evropian, gjegjësisht, adresimit të kërkesave të pakos së Agjendës për Reforma Evropiane, në veçanti rishikimi i Ligjit për Shërbimin Civil, organizimin e administratës publike dhe implementimi i Ligjit për Pagat janë prioritet i yni.

Ne do të përbyllem pakon legjislative për administratën publike si dhe do të reformojmë funksionet e administratës të ndërlidhura me menaxhimin, planifikimin e politikave, koordinimin dhe monitorimin. Me këtë do të përmisohet ndjeshëm efektshmëria e administratës në nivel lokal dhe qëndror si dhe do të sigurohet përmbushja e obligimeve karshi BE. Gjithashtu, do të sigurohet mbështetja e drejtpërdrejtë buxhetore e Bashkimit Evropian prej 25 milionë euro e premtuar për administratën publike.

1.3. Arsimi:

Përkundër investimeve në infrastrukturë, gjëndja në arsim mbetet e mjerueshme. Rezultatet e nxënësve kosovarë në teste të standardizuara më së miri tregojnë nivelin dhe performancën e dobët të sistemit të arsimit në Kosovë.

Për më tepër, edhe ky sektor është ngusht i lidhur me biznesin dhe paranë, çka e ka bërë thujtë të pamundur ndryshimin cilësor pa një qeverisje e cila nuk është e kontrolluar nga interesat e ngushta të grupeve dhe personave të caktuar.

Ne do të punojmë për të ndryshuar këtë trend duke bërë një reformë të thellë e cila do të përfshij tre nivele dhe e cili do të bazohet në sistemin e arsimit finlandez, dhe atë: a. prezantimi i pakos së pensionimit të hershëm, b. reformimi përmes trajnimit të vazhdueshëm dhe vlerësimit, digjitalizimit si dhe unifikimit metodologjik i të mësuarit sipas sistemit finlandez në arsimin fillor dhe të mesëm dhe c. arsimit universitar dhe profesional.

- a. Prezantimi i pakos së **pensionimit të parakohshëm** dhe hyrja në sistem e profesionistëve të rinjë do t'i hapte rrugë reformës kaq shumë të nevojshme në sistemin arsimor, kjo duke i'u mundësuar të gjithë atyre që e kanë të nevojshëm largimin nga sistemi arsimor.
- b. Aktualisht **sistemi i arsimit vuan nga eksperimentet e shumta**. Në Kosovë të ndikuar edhe nga mos-koordinimi i donatorëve është eksperimentuar në shumë drejtime, duke mos krijuar një sistem metodologjik të unifikuar për çka diferenca në shkolla sidomos fshat – qytet është e dukshme.

Me qeverisjen tonë ne do të krijojmë unifikim metodologjik të të mësuarit sipas sistemit finlandez në të cilin vihen në shprehje shkathtësitë dhe të nxënit; përveç se të menduarit kritik dhe mësimit digjital.

Gjatë mandatit tonë në secilën shkollë fillore dhe të mesme do të krijohen qendrat kreative që kanë për qëllim nxitjen e të mësuarit në shkenca ekzakte (Shkencë, Teknologji, Inxhiniering dhe Matematikë).

Po ashtu, për mësimdhënësit do të organizohen trajnime dhe vlerësime të vazhdueshme me qëllim të përmasimit të shkathtësive, aspekte pedagogjike dhe të mësuarit me nxënësin në qendër. Vlerësimi po ashtu do të jetë i përvitshëm dhe mbi bazën e objektivave të para-caktuara në nivelin menaxherial dhe prindërit. Gjatë qeverisjes sonë do të aplikohet mësimi tërë-ditor në të gjitha shkollat e Kosovës dhe ky është hapi i parë drejt implementimit të reformës sipas modelit finlandez.

- c. **Arsimi universitar dhe profesional** do të orientohet në dy nivele kryesore dhe atë: Reformimin e universiteteve publike dhe forcimin e arsimit profesional duke e ndërlidhur me nevojat e industrisë; do të bëhet një rishikim i nevojave për të gjitha universitetet publike ekzistuese mbi bazën e të cilave do të orientohet e ardhmja e të njëjtave, e lidhur me industrinë dhe nevojat e tregut.

Me theks arsimi profesional do të forcohet, kjo duke krijuar kuadro profesionale për nevoja të tregut. Gjatë qeverisjes sonë do të themelohet **Instituti Kombëtar i Kërkimeve për Shkencë dhe Teknologji** me qëllim të përafrimit të industrisë dhe akademisë. Ky institut do të ketë buxhet të dedikuar për inovacion dhe do të punoi ngushtë me ekosistemin e ndërmarrësisë, për të zhvilluar ide biznesi.

Do të ofrohen **bursa të plota për të gjitha studentët të cilët do të pranohen në top 50 universitet** botërore për nivelin bachelor, master dhe doktoratë me fokus në sektorët e STEM (Shkencë, Teknologji, Inxhiniering dhe Matematikë).

Universitetet publike do të kenë **inkubatorë biznesi për studentët** që kanë ide inovative dhe dëshirojnë ta shndërrojnë atë në biznes.

Të gjithë studentët në universitetet publike, do të pajisen me **kartën e posaçme studentore**, si pjesë e kartave ndërkombëtare, përmes së cilës mund të përfitojnë një sërë lehtësirash financiare, duke përfshirë lehtësime në transporte publike, shërbime spitalore, udhëtime

ndërkombëtare, teatro, kinema, librari dhe çdo gjë që studentët përdorin gjatë periudhës studentore. Kjo kartelë do të jetë pjesë e një grupi ndërkombëtarë dhe si rezultat, lehtësirat do të shërbejnë edhe vende të huaja.

1.4. Shëndetësia:

Shëndetësia është sektor tjetër i shërbimit publik i cili është rënd i korruptuar dhe ka nevojë emergjentë për ndryshim rrënjësor. Që nga paslufta të gjitha qeveritë kanë dështuar të krijojnë një sistem shëndetësor i cili i përgjigjet kërkesave të qytetarëve të Kosovës. Si pasojë mbi 100 milion euro të qytetarëve të Kosovës shpenzohen jashtë vendit për të marrë shërbime shëndetësore çdo vit.

Kjo praktike me ne në qeverisje do të ndërpritet. Reforma jonë është e bazuar në dy drejtime dhe atë: a. ndërhyrjet e menjëhershme dhe b. hyrjen e kapitalit privat në sistemin shëndetësor.

Për sa i përket veprimit të parë, brenda dy viteve të para do të: a. themelojmë fondin për sigurimet e detyrueshme shëndetësore, b. reformojmë strukturën e menaxhmentit dhe c. Sigurojmë që kujdesi shëndetësor primar do t'i përgjigjet nevojave publike.

Ndërsa për veprimin e dytë, brenda mandatit 4 vjeçar do të iniciohet ndryshimi më i madh në sistemin shëndetësor në Kosovë që nga paslufta duke lejuar hyrjen e kapitalit privat në Qendrën Klinike Universitare dhe Spitalet Regjionale.

Pra me Aleancën Kosova e Re, qytetarët jo vetëm që do marrin shërbim spitalor profesional të sjellë nga sektori privat, por, çfarë është më rendësi, ato shërbime nuk do të paguhen nga qytetari por nga sigurimi shëndetësor shtetëror.

Për më tepër, duke përfshirë kapitalin privat përmes partneritetit publiko privat, investimet në spitale të reja do të bëhen nga sektori privat, i cili do të kompensohet përmes shërbimeve spitalore që paguhen nga fondi i sigurimeve shëndetësore. Ky sistem, praktikë e botës së zhvilluar, mundëson shërbim më të mirë, spitale më të mira dhe profesionalizëm.

1.5. Rritja ekonomike dhe punësimi:

Zhvillimi ekonomik dhe krijimi i vendeve të punës mbetet forca më e madhe e Aleancës Kosova e Re. Kosova ka vuajtur nga: mungesa e investimeve të huaja direkte, krijimi i incentivave për rritjen e qëndrueshme të bizneseve të vogla dhe të mesme si dhe luftimin e ekonomisë joformale. Aktualisht sipas të dhënave të FMN-së, rreth 30 % e GDP është nga ekonomia jo-formale. Kjo duhet të ndryshojë.

AKR sheh zhvillimin ekonomik të bazuar në 10 shtylla kryesore. Të gjitha këto shtylla kryesore ndihmojnë që Kosova, si çdo ekonomi e zhvilluar, të jetë pjesë e ekonomisë globale dhe jo e mbyllur siç ka qenë deri tani. Të qenurit pjesë e ekonomisë globale, mundëson që pjesë të proceseve, të fokusuara në klastere specifike, të bëhen në Kosovë, thënë ndryshe, prodhimi i një pjese të një produkti

të avancuar bëhet në Kosovë. Për të qenë të suksesshëm, AKR do të zhvilloj 10 shtylla kryesore:

1. **Infrastruktura:**

Për të pasur qëndrueshmëri në zhvillim të vendit, infrastruktura përkrahëse është një domosdoshmëri. Pa një energji stabile dhe pa transport të lirë të mallrave, nuk mund të ketë investime serioze si nga investitorët e huaj, ashtu edhe nga ata lokal, prandaj AKR do të fokusohet në finalizimin e projekteve të mëdha strategjike infrastrukturore, me fokus të veçantë në ndërtimin e termocentralit të ri, lidhjen me gaz përmes Shqipërisë dhe Maqedonisë, rritjen e licencave të energjisë diellore dhe asaj me erë si dhelinjën hekurudhore me Shqipëri, deri tek porti i Durrësit dhe/apo Shëngjinit.

2. **Investimet e Huaja**

Konkurenca e shteteve të rajonit dhe ato të Evropës për të tërhequr investime të huaja direkte është tejet agresive. Shumë shtete në rajon ofrojnë pako të ndryshme për të subvencionuar investitorët e huaj në mënyrë që të bindin ata të investojnë në shtetet përkatëse. Pakot e ofruara vijojnë nga 10,000 EUR për vend pune të gjeneruar e deri tek grantet në formë të parasë së gatshme me vlerë prej 500,000 EUR për investim.

Kosova është i vetmi vend që nuk ka krijuar stimuj të tillë, gjë që hasë në vështirësi në tërheqjen e investitorëve serioz.

AKR, me programin e saj, do të krijoj biznes parqe në vende të ndryshme strategjike në Kosovë, të cilat ofrojnë infrastrukturë të plotë, me lidhje direkte në rrugë kryesore dhe me objekte të gatshme modulare që i përshtaten nevojave të investitorëve. Këto parqe do të investohen nga Fondi Zhvillimor i Kosovës dhe do të jenë të vet qëndrueshme financiarisht, pasi që do të paguhet një qira me çmim të tregut. Nga ana tjetër, buxheti i Kosovës, përmes Agjencisë për Mbështetjen e Ndërmarrjeve dhe Investimeve në Kosovë (KIESA), do të ofroj subvencionim të qirasë për 10 vitet e para, duke bërë Kosovën atraktive për të sjellë investime të huaja.

3. **Eksporti**

Eksportet ndikojnë direkt në rritjen e brutoproduktit vendor. Për më tepër, ato gjenerojnë vende pune dhe njëkohësisht përmirësojnë bilancin tregtar dhe gjëndjen makroekonomike të vendit. Prandaj, AKR do të ketë rritjen e eksporteve në prioritetet e tyre ekonomike.

Për të qenë të suksesshëm në rritje të eksporteve, AKR do të themeloj Agjencinë e Eksporteve të Kosovës, ku qëllimi kryesor do të jetë promovimi dhe gjetja e tregut për produktet e prodhuara në Kosovë. Agjencia do të jetë e vet qëndrueshme pasi që do të operoj në bazë të komisioneve të pranuar për çdo kontratë të shitjes të realizuar.

Po i njëjti agjencion, do të jetë përgjegjës për të organizuar panaire, për të marrë pjesë në panaire ndërkombëtare si dhe për të organizuar takime në mes bizneseve prodhuese vendore dhe atyre blerëse ndërkombëtare.

Gjithashtu, Agjencioni i Eksporteve të Kosovës do të jetë përgjegjës për ta krijuar dhe promovuar një brend të përgjithshëm shtetëror për prodhimet lokale kualitative. Ky brend do të ketë kushte strikte të certifikimit dhe do të krijoj një imazh pozitiv mbi produktet kosovare jashtë vendit.

4. Politikat Fiskale

Në mënyrë që të jemi të suksesshëm në tërheqjen e kompanive që kanë për qëllim eksportin, duhet të avancojmë një hap para me tatimin në fitim të korporatave. Kosova, edhe pse shumë kompetitive në sistemin tatimor, ka nevojë që të jetë një hap para rajonit. Si rrjedhojë, AKR në ditët e para të mandatit, do të bëj ndryshimin e ligjit për tatimin mbi të ardhurat e korporatave duke hequr tatimin në fitim që vije si pasojë e eksportit.

Gjithashtu, AKR do të eliminon pagesën e TVSH dhe doganës për të gjitha lëndët e para që kanë për qëllim eksportin si dhe do të shtyjë pagesën për këto taksa para se produkti të merr formën finale brenda Kosovës. TVSH dhe taksa doganore (nëse aplikohet) do të paguhen vetëm atëherë kur produkti shitet brenda Kosovës.

5. Konkureshmëria

Ekonomia joformale, përveç që ndikon direkt në dëmtim të buxhetit të Kosovës, vazhdon të shkaktoj probleme serioze për kompanitë që punojnë në mënyrë të drejtë. AKR mendon se burimi kryesor i ekonomisë joformale është Dogana dhe ATK, gjegjësisht mbledhja e TVSH-së dhe Doganës në burim për produktet që shërbejnë si lëndë të parë dhe gjysmë produkte. Kjo shkakton problem në tërë zinxhirin prodhues brenda vitit, duke e ulur edhe vlerën e produktit të prodhuar, rrjedhimisht bruto produktin vendor.

AKR, përmes politikave dhe lehtësirave doganore, do të eliminoi këtë dukuri. Siç është përshkruar në pikën 4 të politikave fiskale, me eliminimin e nevojës që të paguhen TVSH dhe Dogana paraprakisht, kompanitë do të stimulohen që të paraqesin vlerën dhe sasinë reale të produkteve të importuara si lëndë e parë.

Gjithashtu, këto dy institucione do të forcohen me inspektorë shtesë për të siguruar kontrollë më të rreptë të keqpërdorimeve të mundshme që mund të shkaktohen si rrjedhojë e lehtësirave fiskale.

6. Bujqësia

Ky sektor jetik ende mbetet ndër potencialet më të mëdha të pashfrytëzuara. Pjesëmarrja e saj në BPV nuk ka ndonjë ngritje të

shpejtë, ndërsa kërkesat gjithnjë në rritje për ushqim mbulohe nga importi.

Në vizionin qeveritar kësaj dege nuk i është kushtuar rëndësi, meqenëse edhe ato pak ndarje buxhetore, kryesisht përmes subvencioneve dhe garantëve, kanë shkuar në duar të gabueshme, apo edhe kanë shërbyer për qëllime korruptive.

Për AKR-në, bujqësia ka qenë, është dhe do të mbetet sektor i rëndësisë së veçantë dhe sferë ku ka ende shumë hapësirë për rritje të produktivitetit dhe përparësi krahasuese me vendet e rajonit. Vizioni ynë është për një bujqësi me ndikim më të madh në mbështetjen e zhvillimit ekonomik të vendit dhe që siguron të ardhura të mjaftueshme për fermerët tanë.

Do t'i hapim tri platforma agroekonomike (gjatë katër vjetëve të qeverisjes), në kuadër të së cilave do të ketë shkollë të mesme profesionale, laboratorë dhe objekte procesuese - prodhuese për produkte bujqësore (mish dhe produkte nga mishi, qumësht dhe produkte nga qumështi, pemë dhe perime, materiale paketues). Këto qendra do të bashkëpunojnë me fshatarin dhe pronarët e tokave, si dhe fermerët për të siguruar kualitet përmes certifikimeve ndërkombëtare. Të gjithë fermerët do të kenë të garantuar shitjen e produkteve të tyre përdërisa punojnë sipas standardeve të caktura si dhe do të kenë çmime të garantuara preferenciale. Ndërkohë, platformat agroekonomike do të bashkëpunojnë me brende ndërkombëtare që produktet e shitura të përfaqësojnë një brend që mund të shitet në tregun lokal dhe atë ndërkombëtar.

Gjithashtu, do të ngritën qendra grumbulluese së paku në shtatë qendra të Kosovës. Qendrat do të ngritën sipas sistemit PPP si dhe do të përdoren për procesim dhe paketim për brende ndërkombëtare. Produktet finale mund të shiten për tregun vendor dhe atë ndërkombëtar.

7. Bizneset Fillestare

AKR do të ndërlidhë ngusht Institutin Kombëtar për Shkencë dhe Teknologji me platformën e bizneseve fillestare, të cilat do të zhvillojnë ide të reja përmes një infuzioni kapital të kombinimit grant/kredi e butë.

Për më tepër, Fondi Zhvillimor i Kosovës, do të ketë një komponentë të veçantë që do investoj në ide inovative, në shkëmbim të aksioneve të kompanisë së re.

AKR do të finalizoj investimet në TechPark Prishtina dhe në Qendrën për Ekselencë Digjitale në Prizren. Të dy këto projekte, do të jenë shtylla kryesore në zhvillimin e ideve dhe fillimin e bizneseve të reja në fushën e teknologjisë dhe informacionit.

Gjithashtu, AKR do të heq tatimin në fitim për 3 vitet e para të operimit për të gjitha bizneset fillestare.

8. Ndërmarrjet e Vogla, të Mesme dhe Industria

AKR do të bëj strategjinë e re për zhvillimin e sektorit privat, duke lëvizur nga industrinë me fuqi punëtore me shkathësi të ulët siç janë industria e tekstilit, drurit dhe metalit, në industrinë me shkathësi të avancuar, me fokus të veçantë në shërbime në teknologji dhe informacion, energji të ripërtëritshme, metale me precizitet të lartë (autopjesë), industri të avancuar të drurit me dizajner vendor/ndërkombëtar (vlerë e shtuar për eksport), teknologji të avancuar dhe prodhimi të pajisjeve elektronike.

AKR do të subvencionoi interesin e kredive për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe do financoi pjesëmarrjen në vizita biznesore apo pjesëmarrje në panairë të ndryshme.

AKR, gjithashtu do të ketë fokus në sektorin minerar, ku mineralet e eksploatuara nuk do të eksportohen si të tilla, por do të mundësoj përpunimin e brendshëm deri në gjysmëprodukt. Kosova është e pasur me 79 minerale të ndryshme dhe me një plan të mirë, mund të rris produktivitetin në Kosovë si dhe mund të angazhoj fuqi punëtore të avancuar për të përpunuar metalet dhe mineralet brenda territorit të Kosovës. Kjo do të mundësonte që eksportet dhe punësimi të rriten dukshëm në krahasim me atë se çfarë është bërë që 20 vite nga pas lufta.

9. Gjykata Ekonomike

AKR do të themeloi Gjykatën Ekonomike e cila ka për qëllim të trajtoj lëndët komerciale brenda një afati kohor maksimal prej 120 ditësh.

10. Fondi Zhvillimor i Kosovës

AKR brenda vitit të parë, do të themeloi Fondin Zhvillimor të Kosovës e cila do të jetë kompani publike me pronësi të Qeverisë së Kosovës e cila merret me zhvillimin e bizneseve me partneritet publiko privat, duke rritur vlerën e asetëve publike, për t'i shitur ato me një vlerë të shtuar. Fondi poashtu parasheh investime në kompani të zhvilluara dhe në ato fillestare ku ka potencial për kthim.

Për më tepër, ky fond do të jetë përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e parqeve biznesore, nga ku do të ketë të hyra shtesë.

Fondi është i vet qëndrueshëm dhe do të jetë kontribuues i madh në buxhetin e Republikës së Kosovës.

1.6. Sistemi pensional:

Qeverisja jonë do të rishikojë skemat pensionale drejt krijimit të një skeme të vetme. Aktualisht janë disa dhjetëra skema pensionale të ndara jo drejtë mes kategorive që përfitojnë nga të njëjtat. Me theks do të rishikohet skema

pensionale e veteranëve të luftës. Paraprakisht është vendosur një kufi i shpenzimeve për veteranët në 0.7 % të GDP-së në bashkëpunim me FMN. Ne zotohemi të ruajmë këtë kufi me tendencë të uljes brenda mandatit qeverisës.

1.7. Çështjet e sigurisë

Kosova vazhdon të perceptohet si vend me kriminalitet të lartë. Gjithashtu, perceptimi publik për organet e rendit dhe të sigurisë nuk është ai i viteve të mëparshme. Ne, vlerësojmë së përmasimi i mekanizmit polici, hetuesi dhe prokurori është boshti I krijimit të një sistemi të besueshëm. Gjatë mandatit tonë ky bosht bashkëpunimi do të rritet.

Gjithashtu, element tjetër i rëndësishëm është fuqizimi tutje i mekanizmave inspektues brenda policisë së Kosovës për çka ne do të krijojmë trupa të veçantë me qëllim të adresimit të problemeve brenda Policisë së Kosovës.

Ne synojmë futjen në sistem të profesionistëve të çështjeve të sigurisë si dhe ripërtëritjen e trupës policore. Kontrolli sistematik dhe i rreptë i organeve menaxheriale brenda Policisë së Kosovës është gjithashtu një nga aspektet për të cilat do i kushtohet kujdes, siç do i kushtohet kujdes i veçantë trajnimit të vazhdueshëm të policisë së Kosovës përmes binjakëzimit me policitë e vendeve të zhvilluara dhe mike të Kosovës. Po ashtu, përmirësimi tutje i trajtimit dhe kushteve të trupave të sigurisë do jetë prioritet gjatë mandatit qeverisës.

Për sa i përket Ushtrisë së Kosovës ne do të vazhdojmë kujdesshëm fazën e transformimit të FKS-së në Ushtri duke respektuar në plotni standardet e NATO-së si dhe duke rritur kujdesin institucional.

1.8. Rinia, Sporti dhe Kultura

Kosova ka ndër pasuritë më të çmuara në botë – rininë dhe përkushtimi për ofrimin e mundësive më të mira për edukim, sport, kulturë dhe perspektivë në karrierë, garanton ta shndërrojë atë në energji pozitive dhe zhvilluese për vendin tonë. Kosova i ka sjellur botës shumë sportistë e artistë të suksesshëm. Pra talenti dhe energjia ekziston tek rinia e jonë, por jo çuditërisht këta emra lulëzojnë vetëm jashtë Kosovës. Është infrastruktura ajo që e bënë këtë talent të dalë në pah dhe pikërisht kjo infrastrukturë e ofruar do të jetë prioritet i Aleancës Kosova e Re, duke krijuar qendra rekreative sportive, kulturore dhe edukative në të gjitha qytetet kryesore të Kosovës.

Për më tepër, me Aleancën Kosova e RE, rinia do të fuqizohet duke:

- Zhvilluar ligjin për vullnetarizëm që parasheh njohje kombëtare të punës vullnetare;
- Krijuar dhe ofruar hapësirë për qendrat rinore si dhe duke mbështetur financiarisht;
- Njohur zyrtarisht profesioni Punëtor Rinor;
- Krijuar nën kodin buxhetor për të gjitha komunat, dedikuar aktiviteteve për rini;
- Rritur investimet kapitale në edukim jo formal.

Përmirësimi dhe zhvillimi i infrastrukturës sportive në të gjitha komunat në Kosovë është prioritet. Ne zotohemi në krijimin e modeleve të infrastrukturës së avancuar sportive me qëllim të ofrimit të mundësive për të gjithë për të ushtruar në mënyrë profesionale sportet individuale ose ato kolektive.

Për më tepër, ne zotohemi për avancimin e sportit si aspekt edukativ në shkollimin formal fillor dhe të mesëm. Implementimi i Ligjit për Sponsorizime dhe krijimi i mekanizmave të tjerë ligjore me qëllim të afrimit të industrisë/afarizmit me sportin do të jetë element kyçë i punës sonë për mandatin qeverisës.

Po ashtu, ne do të avancojmë skemat mbështetëse për sportistët meritore të cilët arrijnë suksese në nivel evropian dhe botëror. Funksionalizimi i teatrove lokale, ruajtja e trashëgimisë kulturore, mbështetja e festivaleve me famë dhe të dëshmuara tashmë, ndërtimi i sallës koncertale si dhe themelimi i muzeut të luftës së fundit në Kosovë, mbesin dedikim i Aleancës Kosova e Re që të finalizohen si projekte të nevojshme për vendin.

1.9. Mjedisi dhe Energjia

Energjia mbetet një ndër sfidat kryesore në zhvillimin ekonomik të vendit. Humbjet që shkaktohen për biznesin nga furnizimi i paqëndrueshëm me energji elektrike kapin shifrën prej 330 milion euro brenda vitit sipas raportit të USIAD. Me neve ne qeveri kjo do të ndryshojë.

Zëvendësimi dhe rehabilitimi i kapaciteteve gjeneruese konvencionale me qëllim të përmbushjes së kërkesave energjetike është objektivi dhe sfida numër një të cilës do i japim zgjidhje.

Gjithashtu, Integrimi në tregun rajonal, në veçanti krijimit të tregut të përbashkët energjetik me Shqipërinë do të përmirësojnë ndjeshëm furnizimin me energji elektrike.

Objektivë e rëndësishme e qeverisjes tonë është promovimi i mëtejshëm i investimeve në gjenerimin e energjisë së pastër si dhe zbatimin e masave të efikasitetit të energjisë, pra ndërtimin e një portofoli mikse të gjenerimit të energjisë. Kujdes i veçantë do i kushtohet edhe instalimit të ngrontoreve qendrore në të gjitha qytetet kryesore të Kosovës që do të përkthehet në kursim të energjisë elektrike për ngrohje, zvogëlim të përdorimit të qymyrit dhe drurit për ngrohje, masa të cilat drejtpërdrejtë do të ndikojnë në rregullim të disbalancit energjetik në mes të verës dhe dimrit si dhe do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në ruajtje të ambientit.

Secila masë e marrë në sektorin energjetik do të ketë për qëllim zbatimin e Strategjisë së Energjisë 2017-2026 dhe do të jenë në përputhje të plotë me direktivat e BE-së.

Për më tepër, do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në përmbushjen e Strategjisë së Mjedisit dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Mjedisin, që do të ndikojë në përmirësim të ndjeshëm të ambientit.

Ne do të angazhohemi të fuqizojmë përgjegjësinë për administrimin e burimeve ujore, bujqësisë, pylltarisë, industrisë, shëndetit publik, planifikimit të përdorimit të tokës dhe çështjeve të lidhura me mjedisin, të cilat janë nën presion të vazhdueshëm për t'iu përgjigjur ndikimeve të papara të ndryshimeve klimatike si përmbytjet e mëdha, thatësira të rënda, degradimi i ekosistemit dhe zvogëlimi e shërbimeve të ekosistemit, mungesa e furnizimit me ujë, rritja e ndotjes, format e reja të ndotjes dhe sëmundjet që lidhen me ujin.

1.10. Barazia gjinore dhe fuqizimi ekonomik i gruas

Kujdes i veçantë do t'i kushtohet barazisë gjinore. Kosova vazhdon të rankohet në mesin e vendeve me diskriminimin më të lartë gjinor në Evropë. Ne do të përimitojmë bazën ligjore të përgjithshme në vend me qëllim të trajtimit të barabartë dhe meritore të gruas – kjo duke i'u mundësuar shkollim dhe punësim mbi baza të barabarta.

Po ashtu, jemi dëshmitarë të diskriminimit në vendin e punës të gruas, për çka asnjë qeveri nga paslufta nuk ka trajtuar këtë fenomen. Ne synojmë krijim të iniciativave për sektor të caktuar të cilët do të punësojnë gra me qëllim të fuqizimit ekonomik të gruas në përgjithësi dhe të rritjes së përgjithshme ekonomike në veçanti.

Me ne në qeverisje, barazia gjinore do të zë vend të veçantë në përfaqësimin e gruas në ndërmarrjet publike, duke filluar nga bordet e drejtorëve e deri tek pozitat më të thjeshta, duke respektuar përfaqshim të barabartë dhe kuotë obligative për bordet e drejtorëve.

2. POLITIKA E JASHTME DHE PROCESET INTEGRUESE

Sot për sot shtetësia e Kosovës kontestohet fuqishëm nga Serbia dhe një grup i shteteve të caktuara të cilat përkrahin Serbinë në luftën e saj të hapur kundër shtetësisë së Kosovës.

Është e qartë që Kosova lëngon nga mungesa e një strategjie gjithëpërfshirëse për politiken e jashtme të mirë koordinuar dhe me prioritet të arritshme të cilat kanë për qëllim kryesore konsolidimin e shtetësisë së Kosovës, gjegjësisht vendosjen e Kosovës në radhën e shteteve të moderuara të botës si dhe anëtarësimin në organizata ndërkombëtare e regionale.

Në politiken e jashtme dhe proceset integruese kemi tri prioritetet kryesore brenda 4 viteve të ardhshme dhe atë:

- a. anëtarësimi në OKB dhe organizatat e specializuara të saja,
- b. anëtarësimi në NATO dhe
- c. marrja e statusit të vendit kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Për sa i përket anëtarësimin në OKB, ne vlerësojmë që në përfundim të vitit të dytë të qeverisjes dhe përmbylljes së dialogut me Serbinë (shih në pjesën III) do të bëjmë

aplikimin për anëtarësim në OKB, gjegjësisht në përfundim të mandatit qeverisës anëtarësimin më të drejta të plota. Nuk ka alternative të ndërmjetme dhe as pranim të asnjë statusi tjetër (vëzhgues).

Po ashtu, për sa i përket OKB-së, gjatë dy viteve të para të qeverisjes, do të analizohet kujdesshëm çdo anëtarësim i mundshëm në organizata të specializuara për aq sa formalisht e juridikisht është e mundshme.

Anëtarësimi në NATO gjatë mandatit të ardhshëm 4 vjeçare mbetet përkushtim dhe objektivi kryesor për qeverinë në ardhje.

Jemi dëshmitarë që gjatë viteve të fundit Qeveritë në Kosovë kanë ndjekë çështjen e integritit në Bashkimin Evropian por pa një plan të detajuar të masave dhe veprimeve të cilat duhet të merren për përshpejtimin e procesit të integritit. Për ne, ky proces është i lidhur ngushtë me plotësimin e kriterëve që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) dhe Agjenda e Reformave Evropiane (ARE) dhe të cila janë kryesisht të ndërlidhura me shumë segmente të reformave që prekin çështjet e brendshme. Është e qartë që hartimi i një politike të qëndrueshme karshi vendeve të Bashkimit Evropian dhe institucioneve të BE-së është ajo e cila i nevojitet Kosovës në këtë situatë, prandaj, me adresimin e plot të obligimeve që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) dhe Agjenda e Reformave Evropiane (ARE) synojmë që në përfundim të mandatit 4 vjeçarë të paraqesim kërkesën për marrjen e statusit të vendit kandidat për anëtarësim në BE.

3. DIALOGU ME SERBINË, TAKSA DHE MARRËDHËNIET FQINJËSORE

3.1. *Dialogu me Serbinë:*

Ne synojmë të përmbyllim procesin e dialogut me Serbinë brenda një viti nga marrja e mandatit. Është e qartë që klasa politike në Kosovë duhet të kursehet nga paqëndrueshmëria e pafundme e tensioneve të brendshme politike të cilat kanë shmangur vëmendjen nga çështjet e rëndësishme të cilat duhet të zgjidhen me Serbinë.

Ne do të konsolidojmë një agjendë të qëndrueshme politike të përbashkët me të gjitha forcat politike në Kosovë për adresimin dhe përmbylljen e dialogut me Serbinë mbi bazën e parimeve të qarta për; mos-ndarje të Kosovës ose shkëmbim të territoreve, ruajtjen e bazës kushtetuese të Kosovës: shtet multi-etnik, republikë parlamentare dhe dy nivele të qeverisjes.

Marrëveshja përfundimtare me Serbinë do të përfshijë edhe demarkimin e kufirit. Gjithsesi, si hapë i parë i cili do t'i prijë dialogut është zbërthimi i të panjohurave dhe qëndrimi i shteteve më të fuqishme të botës me theks SHBA, Gjermani, Britani e Madhe dhe Francë.

Të panjohurat që përmban pakoja e ardhshme e dialogut me Serbinë si dhe qëndrimi i shteteve njohëse të Pavarësisë së Kosovës është baza për vazhdimin e dialogut.

3.2. Taksë me Serbi:

Ne jemi për reciprocitet. Tashmë kjo është dëshmuar edhe në vitin 2012 gjatë kohës kur MTI është udhëhequr nga AKR. Për më shumë në maj 2019 nga AKR është propozuar vendosja e taksës prej 5% për mbulimin e shpenzimeve të energjisë elektrike në veri të vendit si kundërpërgjigje e mos-implementimit të marrëveshjes për energji nga ana e Serbisë.

Ne nuk përjashtojmë çfarëdo mase tatimore ose jo-tatimore. Taksë është mjet politik përveç se ekonomik – gjithsesi, nuk mund të përdoret në pafundësi dhe as nuk mund të behet pengesë për të avancuar marrëdhëniet me shtet mike të Kosovës. Çdo vendimi për suspendimin ose largimin e taksës do i paraprijë kuptimi i të panjohurave të pakos së ardhshme të dialogut me Serbinë dhe do të kushtëzohet me masa të tjera me theks respektimin e marrëveshjeve paraprake të arritura në dialogun e Brukselit.

3.3. Marrëdhëniet fqinjësore:

Ne jemi të përkushtuar për të rritur bashkëpunimin me të gjitha vendet fqinje. Integrimi tutje i Ballkanit është kyçe për stabilitet të përgjithshëm.

Partneriteti me Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi do të përkthehet në rritje të shkëmbimit tregtar dhe ekonomik. Gjatë mandatit të ardhshëm 4 vjeçarë, synohet implementimi i Menaxhimit të Integruar të Kufijve me të gjitha shtetet fqinjë. Do të përfundohen projektet infrastrukturore, me theks të veçantë rruga Gjakovë – Shkodër dhe do të synohet krijimi i programeve të përbashkëta në fushën e arsimit, kulturës dhe rinisë. Lëvizja e lirë e fuqisë punëtore gjithashtu është synim i qeverisjes sonë.